

I. Universiteti Politeknik i Tiranës, shpall vende pune për personel akademik pranë Fakultetit të Gjeologjisë dhe të Minierave si më poshtë:

A. 1 (një) vend pune për personel akademik të me kohë të plotë në Departamentin e Burimeve të Energjisë.

Kandidatët për personel akademik me kohë të plotë pranë Departamentit të Burimeve të Energjisë në fushën e Konstruksionit të Puseve/Regjimit dhe Shtreberimit të Puseve, duhet të plotësojnë kriteret përcaktuese si më poshtë:

1. Të zotërojnë diplomë të sistemit 5 vjeçar ose sistemit 3 + 2 (Bachelor + Master i Shkencave) të studimeve në degën “Inxhinieri Naftë dhe Gazi”/”Inxhinieri e Burimeve të Energjisë” në Fakultetin e Gjeologjisë dhe të Minierave, UPT;
2. Të kenë notë mesatare të studimeve Bachelor + Master i Shkencave ose sistemi 5 vjeçar **mbi 8.00/10.00;**
3. Të njohë (provuar me dokumentin përkatës) një gjuhë të huaj (Anglisht, Gjermanisht, Frëngjisht apo Italisht, me preferencë gjuhën angleze);
4. Të njohë dhe të përdorë lehtësisht programet standarde të Paketës Microsoft Office, ACAD si dhe Programe/Softë të tjera specifike profesionale;
5. Preferohet të kenë përvojë pune (me përparësi në Sektorin e Industrisë së Naftës);
6. Veprimtaria Shkencore dhe Botime përbëjnë përparësi.

II. DOKUMENTACIONI DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

1. Letër motivimi;
2. Jetëshkrimin (CV) sipas formatit standard;
3. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
4. Diplomën e studimeve universitare dhe listën e notave të noterizuara; (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MAS);
5. Fotokopje të librezës së punës të noterizuar;
6. Vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore;
7. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
8. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e paraqitur;
9. Dëshminë e gjuhës së huaj të noterizuar.

Të gjithë kandidatët duhet të paraqesin brenda datës **22.09.2023** pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike në Rektoratin e Universitetit Politeknik të Tiranës, dokumentacionin e sipërcituar.